

Në bazë të nenit 36 paragrafi 1 pika 1 dhe pika 15 të Ligjit për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 05/02), nenit 46 paragrafi 7 të Ligjit për planifikim urbanistik (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 32/20, 111/23, 73/24, 224/24, 40/25, 101/25 dhe 127/25) dhe në pajtim me Vendimin e Këshillit të Komunës së Kërçovës me nr. 08-175/8 nga dt. 31.01.2022, Këshilli i Komunës së Kërçovës, në seancën e \_\_\_\_\_, të mbajtur më \_\_\_\_\_, miratoi:

## RREGULLORE

### për punën e trupit participativ nga fusha e urbanizmit të Komunës së Kërçovës

#### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

##### Neni 1

Me këtë Rregullore rregullohen çështjet e procedurës dhe mënyra e punës së Trupit participativ nga fusha e urbanizmit të Komunës së Kërçovës (në tekstin e mëtejme: Trupi participativ), si dhe çështje të tjera nga kompetenca e Trupit participativ.

#### KOMPETENCAT E TRUPIT PARTICIPATIV

##### Neni 2

(1) Trupi participativ i përfaqëson të gjitha interesat e ndryshme dhe grupet e interesit në bashkësinë lokale dhe i përcjell qëndrimet, mendimet dhe nevojat e qytetarëve dhe të personave juridik; i ndjek gjendjet në planifikim përmes dhënies së iniciativave, udhëzimeve dhe sugjerimeve për përgatitjen e zgjidhjeve planore dhe, në procedurën e hartimit dhe miratimit të planeve, i shqyrton programet planore dhe zgjidhjet planore të planeve urbanistike në versionin e tyre të punës.

(2) Trupi participativ ka rol konsultativ në procedurën e hartimit dhe miratimit të planeve urbanistike; në veçanti, e shqyrton programin planor në fazë para se ai t’i propozohet Kryetarit të Komunës për miratim, si dhe planin urbanistik në fazën e zgjidhjes planore urbanistike para se të dërgohet për revizion profesional.

(3) Puna e Trupit participativ është publike.

## ORGANIZIMI I TRUPIT PARTICIPATIV

### Neni 3

Kryetari i Komunës, me Aktvendim për formim, i emëron të gjithë anëtarët e Trupit participativ.

### Neni 4

(1) Trupi participativ ka së paku 9 anëtarë, ndërsa kufiri i sipërm i numrit të anëtarëve nuk përcaktohet.

(2) Në Trupin participativ marrin pjesë:

- anëtarë të Komisionit për urbanizëm të Komunës së Kërçovës, të emëruar me Aktvendim të veçantë nga Kryetari i Komunës së Kërçovës. Çdo ndryshim në përbërjen e Komisionit për urbanizëm pasqyrohet edhe në përbërjen e Trupit participativ.
- persona të paraqitur vullnetarisht, përfaqësues të shoqatave dhe aktivistë qytetarë nga territori i Komunës, të cilët përfaqësojnë grupet e ndryshme të qytetarëve, si dhe qytetarë që janë persona profesionistë nga fusha e planifikimit urbanistik dhe fusha të tjera profesionale thelbësore për planifikimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Komunës.
- së paku një person profesional i punësuar në personin juridik që e harton planin urbanistik që është objekt i diskutimit.
- përfaqësues nga secila Bashkësi Urbane dhe secila Bashkësi Vendore në Komunën e Kërçovës. Është e mundur që disa bashkësi urbane dhe bashkësi vendore të kenë një anëtar të përbashkët që do t'i përfaqësojë.

(3) Pjesëmarrja e personave të punësuar në Komunën e Kërçovës në Trupin participativ është me detyrë zyrtare, ndërsa për personat që nuk janë të punësuar në Komunë, pjesëmarrja është në bazë vullnetare.

(4) Për punën e Trupit participativ nuk parashihet kompensim.

### Neni 5

(1) Për përfshirjen në punën e personave të paraqitur vullnetarisht, Komuna shpall thirrje publike së paku një herë në çdo 4 (katër) vjet, e cila publikohet në ueb-faqen e Komunës së Kërçovës, si dhe në formë të shkruar me vendosjen e shpalljes në vend publik, në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

(2) Të gjitha aplikimet e dorëzuara shqyrtohen nga Kryetari i Komunës dhe Kryetari i Komunës, me aktvendimin për formimin e Trupit participativ, përcakton se cilët nga personat e paraqitur në thirrjen publike do të jenë anëtarë të Trupit participativ.

(3) Personat e paraqitur vullnetarisht që janë bërë anëtarë të Trupit participativ mund ta tërheqin anëtarësinë e tyre, për çka e njoftojnë me shkrim Kryetarin e Komunës.

(4) Anëtarët e Trupit participativ të paraqitur vullnetarisht, të cilët nuk do t'u përgjigjen thirrjeve, nuk marrin pjesë në seanca dhe nuk marrin pjesë aktive në punën e Trupit participativ, mund të shkarkohen nga Kryetari i Komunës së Kërçovës.

(5) Në rastet e paragrafit (3) dhe paragrafit (4) të këtij neni, Kryetari i Komunës përgatit Aktvendim për ndryshimin e strukturës së Trupit participativ.

## MËNYRA E PUNËS SË TRUPIT PARTICIPATIV

### Neni 6

(1) Trupi participativ punon në seanca.

(2) Seancën e parë pas formimit të trupit participativ e thërret Kryetari i Komisionit për urbanizëm të Komunës së Kërçovës. Në seancën e parë, trupi participativ nga radhët e anëtarëve të vet zgjedh kryetarin dhe zëvendëskryetarin, për çka mbahet procesverbal nga një person i punësuar në komunë. Pas përfundimit të zgjedhjes, kryetari vazhdon me drejtimin e seancës.

(3) Trupi participativ mblidhet së paku një herë në dy muaj, ndërsa seancat i cakton Kryetari me marrëveshje të ndërsjellë me anëtarët.

(4) Të gjithë anëtarët e Trupit participativ mund të iniciojnë mbajtjen e një seance, për zgjidhjen e problemeve urgjente, duke paraqitur iniciativë te Kryetari i Trupit participativ.

(5) Puna e Trupit participativ është publike.

(7) Kryetari i njofton detyrimisht të gjithë anëtarët e Trupit participativ për ditën dhe orën e seancave, ndërsa Trupi participativ në seanca vendimet i miraton me shumicë të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të pranishëm.

(8) Për rrjedhën e punës së Trupit participativ mbahet procesverbal, i cili përmban të dhënat bazë për punën e seancës si: lista e personave të pranishëm, pikat e rendit të ditës, përfundimet dhe vendimet e miratuara, si dhe rezultatet e votimit.

## TË DREJTAT DHE DETYRIMET E KRYETARIT DHE ANËTARËVE TË TRUPIT PARTICIPATIV

### Neni 7

Kryetari i Trupit participativ:

- i thërret dhe i drejton seancat, kujdeset për rendin dhe qetësinë në to dhe merr pjesë në punën dhe vendimmarrjen e Trupit participativ;
- siguron punë të ligjshme të Trupit participativ;
- kujdeset për zbatimin e rregullores së punës dhe i nënshkruan vendimet që Trupi participativ i ka miratuar.

#### Neni 8

Zëvendëskryetari i Trupit participativ zgjidhet në seancën e parë nga radhët e anëtarëve. Në rast të pengesës së përkohshme të Kryetarit, zëvendëskryetari i Trupit participativ i kryen të gjitha punët nga kompetenca e kryetarit, deri në ndërprerjen e pengesës.

#### Neni 9

Anëtari i Trupit participativ:

- merr pjesë në punë dhe vendos për çështjet që janë vendosur në rendin e ditës së seancës;
- jep deklarata, propozime dhe mendime për çështje nga kompetenca e Trupit participativ; dhe
- është i detyruar ta respektojë rregulloren e punës së Trupit participativ.

### DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

#### Neni 10

(1) Këtë Rregullore për punën e trupit participativ nga fusha e urbanizmit të Komunës së Kërçovës e miraton Këshilli i Komunës së Kërçovës, në përputhje me dispozitat e nenit 46 paragrafi 7 të Ligjit për planifikim urbanistik (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 32/20, 111/23, 73/24, 224/24, 40/25, 101/25 dhe 127/25).

(2) Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores bëhet në të njëjtën mënyrë dhe procedurë që vlen edhe për miratimin e saj.

(3) Rregullorja e punës dhe ndryshimet e plotësimet e saj publikohen në “Gazetën Zyrtare të Komunës së Kërçovës”.

#### Neni 11

Rregullorja e punës së Trupit participativ nga fusha e urbanizmit të Komunës së Kërçovës hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Komunës së Kërçovës”, ndërsa do të

fillojë të zbatohet me miratimin e Aktvendimit për formimin e Trupit participativ nga fusha e urbanizmit të Komunës së Kërçovës nga Kryetari i Komunës së Kërçovës.

Број / Nr: \_\_\_\_\_

Од / Prej: \_\_\_\_\_ година / viti

Кичево / Kërçovë

ПРЕТСЕДАТЕЛ / KRYETAR  
НА СОВЕТ НА ОПШТИНА КИЧЕВО / I KËSHILLIT TË  
KOMUNËS SË KËRÇOVËS

Ajhan Sulkoski

---